

KUSHTET E PERGJITHSHME TE SIGURIMIT

Neni 1 - Perkufizime

Aksident – do te konsiderohet nje ngjarje e papritur, e pazakonte, specifike qe ndodh ne nje kohe dhe nje vend te identifikueshem dhe qe shkakton demtime trupore te te Siguararit me pasoje vdekjen apo paaftesine e perhereshme te plote.

Vdekja Aksidentale- Humbja e jetes se te siguararit, si pasoje e nje aksidenti i cili eshte i jashtem dhe i pavarur nga vullneti i te siguararit dhe qe nuk ben pjese ne perjashtimet te kontrates se sigurimit.

Vdekje natyrore - Humbja e jetes se te siguararit, si rrjedhoje e nje semundje te shfaqur gjate periudhes se sigurimit, e cila nuk ka ekzistuar me pare dhe nuk persihet ne perjashtimet e kontrates se sigurimit.

Paaftesia e Perhereshme e Plote – do te konsiderohet paaftesia qe e ndalon totalisht te Siguararin per te kryer cdo lloj veprimtarie ekonomike apo punesimi dhe qe zgjat per 12 muaj kalendarike dhe ne perfundim te kesaj periudhe nuk ka asnje shprese per permiresim. Per qellim te ketij sigurimi do te konsiderohet Paaftesi e Perhereshme e Plote:

- Humbje e plote dhe e pakthyeshme e shikimit ne te dy syte
- Humbje e dy gjymtyreve
- Humbje e plote dhe e pakthyeshme e shikimit ne nje sy dhe humbjen e nje gjymtyre.

Humbje e nje Gjymtyre – do te konsiderohet ndarja fizike e nje dore prej kycit te dores ose e nje kembe prej nyjes se kembes dhe perfshin humbjen e plote dhe te pakthyeshme te funksionit te duarve.

Vonese e Bagazheve - do te konsiderohet vonesa ose transportimi ne nje drejtim te gabuar te pasurise se mbajtesit te kartes per me shume se gjashte ore nga momenti qe mbajtesi i kartes mberrin ne destinacionin e biletës se tij qe eshte i ndryshem nga vendndodhja e vendqendrimi i perhershem

Pasuri e Mbajtesit te Kartes- do te konsiderohet bagazhi dhe sendet personale ne bagazhin qe jane nen kujdesin e nje shoqerie transportuese.

Vonese ne Udhetim- do te konsiderohet vonesa ne nje transport te planifikuar te prenotuar nga i Siguarari, per te pakten 6 ore per nje shkak te paparashikueshem jashte kontrollit te te Siguararit.

Neni 2- Mbulimi ne Kontraten e Sigurimit

Kontraktuesi ka detyrimin te paguaj primin tek Siguruesi, sipas kushteve te percaktuara ne kontraten e sigurimit ose te shtuara ne te. Me kushtin qe i Siguarari te kete paguar plotesisht apo pjeserisht udhetimin permes Visa Classic Card, Siguruesi ka detyrimin ti paguaj te Siguararit perfitimet ne masen dhe menyren e specifikuar ne kete kontrate si me poshte:

Seksioni I. Aksidente Personale ne Udhetim

Siguruesi do te demshperbleje te Siguararin ose Perfituesin ne rast se gjate periudhes se sigurimit i Siguarari demtohet aksidentalisht me pasoje Paaftesine e Perhereshme Totale dhe/ose Humbjen Aksidentale te Jetes deri ne shumen 100,000 Euro, nese aksidenti ndodh:

1. Kur i Siguarari eshte pasagjer ne nje mjet transporti publik (hekurudhe, autobus, anije, avion, taksi, ose automjet me qera me shofer) duke udhetuar per ne ose nga destinacioni i udhetimit te tij dhe bileta eshte paguar me Visa Classic Card
2. Kur i siguarari eshte drejtues mjeti ose pasagjer ne nje automjet me qera, dhe makina e marre me qera eshte paguar me Visa Classic Card

3. Kur i Siguruari është duke qendruar në një aeroport, port, stacion hekurudhor ose rrugor me qëllim imbarkimin/debarkimin në një transport publik, tokësor, detar, ajror, duke përfshirë udhëtimet në dhe nga çdo drejtim dhe nëse bileta është paguar nga Visa Classic Card

Nëse i Siguruari ka blerë një biletë vetëm për një udhëtim (vajtje ose ardhje), mbulimi në sigurim përfundon në destinacion. Nëse i Siguruari merr një taksë ose një mjet tjetër transporti publik, ose merr automjet me qera deri në hotel, atëherë ai do të mbulohet në sigurim. Nëse bileta e blerë është biletë kthimi, i njëjti mbulim zbatohet për udhëtimin e kthimit.

Në rast kerkese për demshperblim i Siguruari ose Perfituesi (trashëgimtaret ligjor) duhet të vëne në dispozicion të Siguruesit:

- Biletën e udhëtimit (e-mail konfirmues për blerjen e biletës në të cilin të jete percaktuar cmimi i biletës, konfirmimin që pagesa është kryer nga Visa Card.)
- Certifikata e vdekjes ose raporti mjeko ligjor për Paaftesine e Perhereshme Totale të të Siguarit.
- Dokumenta nga policia ose autoritet gjyqësore ose çdo autoritet tjetër, kompetencë e të cilit është vërtetimi i ngjarjeve aksidentale, të cilat të vërtetojnë ndodhjen e aksidentit dhe përfshirjen e të siguarit në këtë aksident.
- Çdo dokument tjetër që do të kërkohej në Siguruesi për vlerësimin e rastit të sigurimit.

Demshperblimi që Siguruesi do të paguaj do të llogaritet në përputhje me (i) Shumën e Sigurimit, (ii) përqindjen së sa bileta e udhëtimit është blerë me Visa Card, (iii) si dhe bazuar në përjashtime të zbatueshme për “Seksionin -1 Aksidente Personale në Udhëtim”

Shuma e Sigurimit 100,000 euro është e pagueshme në këtë seksion nëse gjatë periudhës së sigurimit i Siguruari person dëmtim trupor të shkaktuar nga një aksident i cili vetëm dhe në mënyrë të pavaruar nga ndonjë shkak tjetër do të rezultojë në vdekjen dhe/ose Paaftesine e Përgjithshme të të Siguarit.

Seksioni II. Bagazhe të vonuara/humbura

Siguruesi do të rimburojë të Siguarin në rast vonese/ humbje të bagazheve për të pakten 6 (gjashtë) orë nga mbërritja e të siguarit në destinacion. Pagesa e Siguruesit është e kufizuar në shpenzimet e bëra për blerjen emergjente të sendeve thelbësore të nevojshme nga i Siguruari gjatë një udhëtimi të mbuluar dhe në një destinacion, të ndryshëm nga ai i vendbanimit të përhershëm të të Siguarit

Siguruesi do të paguaj shpenzimet për të Siguarin:

- Deri në 50 euro nëse vonesa është 6-12 orë
- Deri në 125 euro nëse vonesa është 12 – 48 orë
- Deri në 375 euro nëse vonesa është më shumë se 48 orë

Në rast kerkese për demshperblim, i Siguruari duhet të vëne në dispozicion të Siguruesit:

- Biletën e udhëtimit (e-mail konfirmues për blerjen e biletës në të cilin të jete percaktuar cmimi i biletës, konfirmimin që pagesa është kryer me kartë Visa Classic.
- Faturat perkatese që vërtetojnë shpenzimet e bëra nga i Siguruari.
- Dokumenta ose formulare që vërtetojnë denoncimin nga i Siguruari të vonesës/humbjes së bagazheve pranë Zyres së reklamimit të bagazheve, si dhe kohën dhe dokumente që vërtetojnë marrjen në dorëzim nga i Siguruari të bagazhit të vonuar.
- Çdo dokument tjetër që kërkohej nga Siguruesi për të vlerësuar rastin e sigurimit.

Demshperblimi që Siguruesi do të paguaj do të llogaritet në përputhje me (i) Shumën e Sigurimit, (ii) përqindjen së sa bileta e udhëtimit është blerë me Kartë Visa Classic, (iii) si dhe bazuar në përjashtime të zbatueshme për “Seksionin -2 Bagazhe të vonuara/humbura”

Seksioni III. Udhetim/Fluturim i vonuar

Ne rast se nisja e nje transporti te planifikuar ne te cilin eshte prenotuar udhetimi vonohet per te pakten 6 (gjashte) ore per shkak te shkaqeve te paparashikueshme jashte kontrollit te te Siguararit, Siguruesi do te rimbursoj shpenzimet e te Siguararit per ushqim dhe akomodim deri ne 125 euro.

Siguruesi do te paguaj shpenzimet e te Siguararit:

- Deri ne 50 euro nese vonesa eshte 6 – 14 ore
- Deri ne 100 euro nese vonesa eshte 14 – 24 ore
- Deri ne 125 euro nese vonesa ehste me shume se 24 ore

Ne rast kerkese per demshperblim, i Siguarari duhet te vere ne dispozicion te Siguruesit:

- Biletën e udhetimit (e-mail konfirmues per blerjen e biletës ne te cilin te jete percaktuar cmimi i biletës, konfirmimin qe pagesa eshte kryer nga Visa Card.)
- Faturat perkatese qe vertetojne shpenzimet e bera nga i Siguarari.
- Dokumenta ose formulare qe vertetojne denoncimin nga i Siguarari te voneses se udhetimit prane Zyres se ankesave si dhe oren e nisjes se udhetimit nga i Siguarari.
- Cdo dokument tjeter qe kerkohet nga Siguruesi per te vleresuar rastin e sigurimit.

Demshperblimi qe Siguruesi do te paguaj do te llogaritet ne perputhje me (i) Shumen e Sigurimit, (ii) perqindjen qe bileta e udhetimit eshte blere me Visa Card, (iii) si dhe bazuar ne perjashtime te zbatueshme per “Seksionin -3 Udhetim/Fluturim i vonuar”

Neni 3- Kushtet dhe Limitimi i Pergjegjsise

Ne rast kerkese per demshperblim mjeku ose mjeket e emeruar nga Siguruesi do te lejohen te ekzaminojne te Siguararin aq here sa te konsiderohet e nevojshme.

Neni 4- Perjashtime

Perjashtime te aplikueshme per Seksionin I. Aksidente Personale ne Udhetim

Siguruesi nuk do te jete pergjegjes per shpenzime qe rrjedhin nga:

1. Vetvrasja ose tentative per vetevrasje e te Siguararit ose vetdemtimi i qellimshem ose ekspozimi i qellimshem ndaj rreziqeve te medha (pervec ne perpjekje per te shpetuar jete njerzore) ose nga aktet kriminale te vete te Siguararit.
2. Vrasje dhe sulm fizik nga persona me të cilët i siguarari ka konflikte të mëparshme, sulme apo veprime e kunderveprime te dhunshme te provokuara me te tretet.
3. Rreziqet e rrembimit, terrorizmit dhe sabotazhit si dhe humbja e jetes ose paaftesia qe shkaktohet si rezultat i luftës, pushtimit, akteve kriminale (pavarësisht nëse lufta është shpallur ose jo), luftra civile, revolucionit, rebelimit, sekuestrimit të personit, trazirave, krimin të organizuar, përdorimit të armëve ose paisjeve të luftës, akteve terroriste, agresionit.
4. Sportet dimerore, ngjitjet malore, alpinizmi, garat sportive, detyrat me forcat e armatosuar, udhetimet toksore nderkombetare ne Azi dhe Afrike, pervec me hekurudhe ose avion, aktrimi profesionist dhe aviacioni pervecse kur fluturon si pasagjer.
5. Paaftesia qe rrjedh direkt ose indirekt nga semundje ose shkaqe natyrore ose trajtime mjeksore apo kirurgjikale.
6. Rrezatimi jonizues ose ndotja nga radioaktiviteti, rezatimet nukleare ose mbetje berthamore, djegja e mbetjeve berthamore, eksplozivet radioaktive ose lendet helmuese, lende te tjera te rrezikshme te cdo lloj perberje berthamore.
7. Nuk do te paguhet asnje perfitim per te Siguararin nga moshja 70 vjec e siper dhe te Siguararin qe udheton ne kundershtim me keshillen e mjekut.

Perjashtime te aplikueshme per Seksionin II. Bagazhe te vonuara/humbura

Siguruesi nuk do te rimbursuje shpenzimet e bera nen kete seksion ne rast se vonesa e bagazheve eshte me pak se 6 ore.

Sende te domosdoshme te cilat nuk mbulohen nga vonesa e bagazheve perfshijne:

1. Lente kontakti, syze, paisje degjimi.
2. Dhemb artificial, ura dentare, proteza, apo aparate/paisje ortodontike
3. Bileta, dokumenta para, letra me vlere, ceqe, ceqe udhetari, sende me vlere, bizhuteri.
4. Modele Biznesi

Perjashtime te aplikueshme per Seksionin III. Udhetim/fluturim i vonuar

Siguruesi nuk do te rimbursoj shpenzimet e bera nen kete seksion ne rast se vonesa e fluturimit eshte me pak se 6 ore.

Siguruesi nuk do te mbuloj shpenzimet nese ato shkaktohen si rrjedhoje e nje prej shkaqeve te meposhtme:

1. Vonesa e te siguruarit
2. Karantina
3. Fatkeqesite natyrore

Neni 5- Kushte te zbatueshme per te gjitha seksionet.

1. Fluturimet carter do te mbulohen ne sigurim nese bileta ose cmimi eshte paguar duke perdoruar Visa Card.
2. Në lidhje me udhëtime të paguara pjeserisht me Visa Card, përfitimet do te llogariten ne perpjestim me perqindjen e cmimit te biletës te blere me kete karte.
3. Periudha maksimale e mbulimit te nje udhetimi eshte 30 (tridhjetë) dite.
4. Kuptohet dhe pranohet se te gjitha mbulimet perfshijne:

Ekspozimin dhe zhdukjen e te siguruarit ne nje aksidenti të mbuluar ne sigurim, kur i Siguruari ekspozohet me menyre te pashmangshme ndaj elementeve dhe si rrjedhoje e ketij ekspozimi peson humbje te jetes per te cilen demshperblimi eshte i pagueshem sipas kushteve te kesaj kontrate. Nëse trupi i personit të siguruar nuk është gjetur brenda dy vjetëve nga zhdukja, mbytja ose shkatërrimi i mjetit me të cilin ishte duke udhetuar ne kohën e aksidentit, atehete do të supozohet se i siguruari ka humbur jetën si rezultat i ketij aksidenti ne te cilin ka ndodhur zhdukja, mbytja, shkatërrimi, dhe ka dokumenta te mjaftueshme qe vertetojne se i Siguruari ka qene brenda ketij mjeti.

5. Është kusht i pergjithshëm për këtë Sigurim që udhëtimi për të cilin kryhet mbulimi ne sigurim nuk është rezervuar ose filluar në kundërshtim me këshillën e mjekut ose pas diagnostikimit te te Siguarit me nje semundje terminale.
6. Per qellim te ketij sigurimi cdo person i siguruar do te konsiderohet i siguruar vecmas.
7. Demshperblimi do ti paguhet personit te Siguar ose Perfituesit ligjor te tij.
8. Te gjitha dokumentat e kerkuara nga Siguruesi do te dorzohen origjinal ose kopje te noterizuara, perkthimi ne gjuhen shqipe do te behet me shpenzimet e te Siguarit ose perfituesit.
9. Siguruesi me shpenzimet e tij mund te filloj proceduren gjygesore ne emer te Personit te Siguar per te marre kompensime nga nje pale e trete ne lidhje me cdo ç'demtim te parashikuar sipas ketij Sigurimi, keshtu qe cdo shume e marre do t'i perkase Siguruesit, ndersa i Siguruari/perfituesi do te japin te gjithe ndihmen e nevojshme Siguruesit.
10. I Siguruari duhet të dorëzojë në ALBSIG JETE SH.A., brenda 45 ditëve nga dita e kthimit në Shqipëri, dokumentet e nevojshme për trajtimin e kërkesave, përndryshe përfitimet do të reduktohen në 30%.